



Zotohemi se do të jemi të hapur
dhe llogaridhënës

Politika e Grupit Titan për Sinjalizim

Qershor 2025

V2.1

Përmbajtja

HYRJE	3
PËRKUFIZIMI	3
Çka është “sinjalizimi”?	3
Kush është “sinjalizues” dhe çka është “shqetësimi për sinjalizim”?	3
QËLLIMI	4
FUSHËVEPRIMI	4
KORNIZA LIGJORE	4
PËRPILIMI I RAPORTIT TË BRENDSHËM	4
Kujt t’i dorëzohet?	4
Si?	5
TRAJTIMI I RAPORTEVE TË DORËZUARA	5
Kontrolli i Raportit	5
Rolet dhe përgjegjësitë kryesore	5
Rishikimi i Raporteve	6
Raportet për Vendim	6
Objektiviteti dhe Pavarësia	6
ANONIMITETI	7
KONFIDENCIALITETI	7
MBROJTJA KUNDËR HAKMARRJES	7
KEQBESIMI DHE AKUZAT E RREME	8
PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE	8
RUAJTJA E RAPORTEVE TË DORËZUARA	8
TRAJNIMI	8
ADMINISTRIMI I POLITIKËS	8

HYRJE

Titan S.A. (“Titan”) dhe filialet e tij (bashkërisht “Grupi Titan”) janë të përkushtuara të bëjnë biznes sipas standardeve më të larta të transparencës dhe integritetit. Të gjithë personat që kryejnë punë për Grupin Titan pritët të ruajnë standardet më të larta të sjelljes etike dhe të ligjshme në punë, në përputhje me Kodin e Mirësjelljes, Vlerat dhe politikat e brendshme të Grupit Titan, dhe ligjet në fuqi, përfshirë Direktivën e BE-së 2019/1937 (“**Direktiva e BE-së për Sinjalizimin**”). Megjithatë, ndonjëherë incidentet e sjelljes së paligjshme ose joetike mund të ndodhin pa vetëdije brenda një organizate. Kultura e të qenit të hapur dhe llogaridhënës është thelbësore për të mbrojtur sjelljen e duhur. Grupi Titan promovon në mënyrë aktive një kulturë ku njerëzit ndihen të lirshëm të shprehën, duke inkurajuar këdo që ka një shqetësim për sinjalizim për ta raportuar atë, me mirëbesim dhe përgjegjësi, përmes kanaleve të sigurta dhe të besueshme për raportim. Sistemi i Grupit për sinjalizim mundëson që shqetësimet të ngrihen dhe të adresohen në mënyrë të përgjegjshme, efektive dhe konfidenciale, duke siguruar mbrojtje të plotë për sinjalizuesit, pa asnjë frikë nga hakmarrja.

Kjo Politikë për Sinjalizim (“**Politika**”) përcakton kornizën për raportimin e incidenteve që lidhen me punën dhe informacionin përkatës që përbëjnë shqetësime për sinjalizimin. Ajo gjithashtu parashikon mbrojtjen kundër hakmarrjes ndaj një personi që raporton incidente të tilla në mirëbesim.

Çështjet që nuk përbëjnë incidente të tilla dhe janë jashtë fushëveprimit të kësaj Politike janë çdo temë e përjashtuar shprehimisht nga fushëveprimi i një sistemi sinjalizues nga ligjet në fuqi.

PËRKUFIZIMI

Çka është “sinjalizimi”?

“Sinjalizimi” është akti i dhënies së informacionit në lidhje me një shqetësim për sinjalizim.

Kush është “sinjalizues” dhe çka është “shqetësimi për sinjalizim”?

Sipas kësaj Politike, “sinjalizuesi” është një person që ngre një “shqetësim të sinjalizimit”, që do të thotë një shqetësim të arsyeshëm dhe me mirëbesim për punën në lidhje me (i) çdo veprim, mosveprim ose sjellje të dyshuar, të vërtetë ose të mundshme, që përbëjnë shkelje të Kodit të Mirësjelljes, Vlerave dhe politikave të brendshme të Grupit Titan, (ii) veprimet që ndikojnë negativisht në reputacionin e Grupit Titan, ose (iii) sjelljet kriminale, sjelljet joetike ose sjelljet të tjera të pahijshme, duke përfshirë dyshimin për shkelje të ligjit kombëtar ose të BE-së brenda Grupit Titan.

Incidentet e raportuara mund të bien në kategoritë e mëposhtme:

- Kontabiliteti, Auditimi dhe Raportimi Financiar**, duke përfshirë anomalitë financiare, transaksionet e gabuara kontabël, evazionin fiskal, çështjet e kontrolleve të brendshme etj.;
- Integriteti i biznesit**, lidhur me ndërveprimet me palët e treta dhe legjislacionin, duke përfshirë ryshfetin dhe korrupsionin, pastrimin e parasë, konfliktin e interesit, çështjet e ligjit të tregtisë dhe konkurrencës, privatësinë e të dhënave, sigurinë e produktit, shpalsjen e paautorizuar të informacionit konfidencial ose të brendshëm, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut etj.;
- Keqpërdorimi ose Përvetësimi i Pasurisë së Korporatës**, në mënyrë specifike lidhur me asetet që keqpërdoren ose përdoren në një mënyrë që nuk pritët, duke përfshirë vjedhjen, raportimin e pasaktë të shpenzimeve etj.;
- Njerëzit, Diversiteti dhe Respekti në Vendin e Punës**, kryesisht i lidhur me marrëdhëniet në vendin e punës dhe të punonjësve ose sjelljen e keqe, duke përfshirë diskriminimin, ngacmimin, hakmarrjen, abuzimin me substanca, kompensimin dhe përfitimet, dhe çështje të tjera të përgjithshme të burimeve njerëzore etj.;
- Mjedisi dhe Shëndeti dhe Siguria**, lidhur me rregulloret mjedisore, rreziqet për shëndetin dhe sigurinë, sigurinë në vendin e punës etj.;
- Shkeljet e ligjit të BE-së**: çdo incident nga kategoritë e mësipërme që përbëjnë në mënyrë specifike shkelje të ligjit të BE-së, sipas Direktivës së BE-së për Sinjalizimin.

Pretendimet për **mashttrim** janë ato incidente të raportuara, nga cilado prej kategorive të mësipërme, të cilat mund të lidhen me veprime të qëllimshme e të paligjshme ose të parregullta që përfshijnë mashttrimin, që synojnë të rezultojnë në përfitime financiare ose personale për kryesin, ku përfshihen asetet e korporatës pa marrë parasysh vlerën.

Ato mund të përfshijnë Ryshfetin dhe Korrupsionin, Përvetësimin e Pasurisë ose skemat mashtroese me Pasqyra Financiare.

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj politike është të:

- krijohet një sistemi gjithëpërfshirës i kanaleve të raportimit;
- inkurajohet dhe lehtësohet raportimi i shqetësimeve për sinjalizim;
- ofrohet korniza dhe standardet për të siguruar që raportet të trajtohen në mënyrë efektive, të merren seriozisht dhe të trajtohen me objektivitete dhe konfidencialitet pa asnjë frikë nga hakmarrja.

FUSHËVEPRIMI

Kjo politikë zbatohet për të gjithë punonjësit, ish-punonjësit, kandidatët dhe personat me të cilët Grupi Titan ka një marrëdhënie pune (siç janë furnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët dhe klientët), duke përfshirë aksionarët dhe personat e lidhur me organet administrative, menaxhuese ose mbikëqyrëse të çdo entiteti të Grupit Titan (përfshirë drejtorët joekzekutivë).

Të gjitha kompanitë dhe njësitë e biznesit të Grupit Titan duhet të sigurojnë që të gjithë punonjësit të kenë njohuri dhe të respektojnë këtë Politikë.

KORNIZA LIGJORE

Kjo Politikë pasqyron angazhimin e fortë të Grupit TITAN për të bërë biznes në mënyrë të ligjshme dhe etike në përputhje me Kodin e Mirësjelljes, Vlerat dhe Politikat e Grupit Titan, dhe ligjet në fuqi, duke përfshirë Direktivën e BE-së për Sinjalizim.

Kjo Politikë mund të plotësohet nga Shtojca, për të siguruar pajtueshmërinë e disa kompanive të Grupit Titan me kërkesat e çdo legjislacioni kombëtar, duke përfshirë kërkesën për të caktuar një person përgjegjës për pranimin dhe monitorimin e raporteve ("RRMR"), ose për të ofruar informacion në lidhje me autoritetet kompetente dhe procedurën për dorëzimin e një raporti të jashtëm. Në rast të ndonjë konflikti midis kësaj Politike dhe Shtojcës, Shtojca do të mbizotërojë. Në rast të një konflikti midis kësaj Politike pasi plotësohet nga çdo Shtojcë dhe çfarëdo rregulli të zbatueshëm kombëtar, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Kjo Politikë nuk ndikon dhe nuk kufizon detyrimin ose mundësinë për dorëzimin e raporteve tek autoritetet kompetente gjyqësore, mbikëqyrëse ose rregullative në çdo vend.

PËRPILIMI I RAPORTIT TË BRENDSHËM

Kujt t'i dorëzohet?

Çdo sinjalizues që ka një shqetësim për sinjalizim, siç specifikohet në këtë Politikë, inkurajohet fuqimisht të raportojë ngjarjet dhe rrethanat që beson në mirëbesim dhe në baza të arsyeshme se kanë shkaktuar shqetësime të tilla për sinjalizim, si në vijim:

- Duke dorëzuar një raport në EthicsPoint**, i cili është sistemi i raportimit i bazuar në rrjet (ueb) dhe telefon të Grupit Titan, i cili mbahet jashtë Grupit Titan nga një ofrues i jashtëm dhe i pavarur i shërbimit për të siguruar grumbullimin konfidencial të të gjitha Incidenteve të raportuara.
Në EthicsPoint, një raport, qoftë anonim ose i nënshkruar, mund të dorëzohet gjatë 24 orëve në ditë, 7 ditë në javë përmes telefonit ose internetit, në anglisht ose në gjuhën lokale.
Konfirmimi i pranimin të raportit do t'i dërgohet sinjalizuesit brenda një afati kohor prej shtatë (7) ditësh nga dorëzimi i tij.
- Dorëzimi i raportit tek Menaxhmenti i Linjës ose i Lartë**, ose drejtpërdrejt tek departamentet përkatëse **Ligjore, të Pajtueshmërisë, Burimeve Njerëzore, Auditimit të Brendshëm**.
Raportet mund të dorëzohen me telefon, me e-mail, me letër ose përmes një takimi personal, nëse kërkohet. Veçanërisht për shkelje të mundshme të Ligjit të BE-së, raportet duhet t'i dorëzohen personit të caktuar përgjegjës për pranimin dhe monitorimin e raporteve (**RRMR**), aty ku është caktuar ai person, dhe siç specifikohet në çdo Shtojcë të kësaj Politike.

Si?

Për të lehtësuar shqyrtimin efektiv dhe kontrollimin e duhur të një raporti, është veçanërisht e rëndësishme që sinjalizuesi të jap:

- një përshkrim të detajuar të ngjarjeve në lidhje me shqetësimin për sinjalizim dhe se si personi raportues i ka kuptuar ato ngjarje;
- datën dhe vendin e incidentit të raportuar në lidhje me shqetësimin për sinjalizim;
- emrat dhe pozitat e punës së personave të përfshirë në incidentin e raportuar në lidhje me shqetësimin për sinjalizim, ose informacionin që mundëson identifikimin e personave të tillë;
- emrin e çdo personi tjetër që mund të vërtetojë veprimet e përcaktuara në raport;
- referencë në ndonjë dokument ose provë tjetër që mund të konfirmojë se ka ndodhur incidenti i raportuar që lidhet me shqetësimin për sinjalizim.

Në rast dyshimi nëse duhet të bëhet një raport, për më shumë sqarime në lidhje me mënyrën e dorëzimit të një raporti ose për çdo pyetje tjetër përkatëse që nuk adresohet në këtë Politikë, inkurajoheni të kontaktoni Departamentet ose personat e caktuar të cilët i pranojnë raportet siç u përmend më lart, ose të përdorni funksionalitetin e parashtrimit të pyetjeve përmes platformës raportuese EthicsPoint.

TRAJTIMI I RAPORTEVE TË DORËZUARA

Kontrolli i Raportit

Të gjitha raportet hetohen menjëherë dhe tërësisht, duke siguruar paanshmëri dhe konfidencialitet absolut ndaj të gjitha palëve të përfshira (p.sh. personat raportues ose të raportuar, dëshmitarët ose personat e tjerë të implikuar), në përputhje me ligjet kombëtare në fuqi.

Për të siguruar një proces hetimi të mirinformuar, grupi përgjegjës për kontrollimin e raporteve do të informojë menaxhmentin ekzekutiv, në varësi të natyrës dhe rëndësisë së çështjes dhe kur nuk ka ndonjë konflikt të dukshëm interesi. Gjithashtu, sipas gjykimit të ekipit përgjegjës për kontrollimin e raporteve, mund të kërkohej ndihmë nga stafi lokal ose i grupit që është kompetent në çdo rast ose mund të kërkohej informacion shtesë nga personi raportues ose individë të tjerë. Nëse është e nevojshme, do të kërkohej ndihma e konsulentëve ose ekspertëve të jashtëm.

Rolet dhe përgjegjësitë kryesore

Varësisht nga ligjet kombëtare në fuqi:

- Menaxhmenti i Linjës / i Lartë** do të trajtojë dhe shqyrtojë, sipas përgjegjësisë dhe pas miratimit të Kryesuesit përkatës të Njesisë Organizative/Funksionit të Korporatës, të gjitha rastet me ndikim të ulët të cilat nuk dorëzohen në EthicsPoint, duke përjashtuar:
 - Akuzat për mashtrim, të cilat duhet t'i përcillen Komitetit Rajonal, shih më poshtë.
 - Çdo shkelje të mundshme e Ligjit të BE-së, të cilat duhet t'i përcillet RRMR-së së caktuar, aty ku është caktuar. Rastet me ndikim të ulët konsiderohen incidente të vetme, jo të përhapura, që kanë të bëjnë me shkelje të vogla me ndikim të ulët financiar ose operacional, që nuk cenojnë reputacionin e kompanisë, që kanë nevojë për një zgjidhje mjaft të thjeshtë dhe të shpejtë. Rastet me konflikte do të përcillen në përputhje me rrethanat, siç specifikohet më poshtë.
- Komitetet Rajonale**, të përbëra nga menaxherë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, Ligjore, Auditimit të Brendshëm dhe Pajtuëshmërisë, dhe RRMR(t) (aty ku janë emëruar), do të shqyrtojnë, trajtojnë dhe bashkërendojnë kontrollimin (ekzaminimin) e të gjitha raporteve të dorëzuara ose të regjistruara në EthicsPoint, si dhe çdo rast tjetër të pranuar drejtpërdrejt nga Komiteti Rajonal, ose që është dërguar tek Komiteti Rajonal ose një anëtar i Komitetit Rajonal nga persona që kanë pranuar/marrë shqetësime për sinjalizim, duke përjashtuar:
 - Çdo shkelje të mundshme e Ligjit të BE-së, të cilat duhet t'i përcillet RRMR-së së caktuar, aty ku është caktuar.
 - Çdo pretendim që është pjesë e procesit gjyqësor, i cili duhet të trajtohet nga Departamenti Ligjor. Hetimi dhe raportimi i çdo pretendimi për mashtrim do të ndërmerret nga Departamenti Rajonal i Auditimit të Brendshëm dhe i Pajtuëshmërisë.

- **Komiteti Mbikëqyrës**, përbëhet nga përfaqësues të menaxhmentit të lartë të Grupit Titan dhe Kryetari i Komitetit të Auditimit dhe Rrezikut në Titan, i cili kryeson mbledhjet e komitetit. Komiteti do të njoftohet për raportet në të gjitha vendet, do të ketë qasje në të gjitha materialet përkatëse, do të mbikëqyrë dhe garantojë efektivitetin e procesit të hetimit, do të ofrojë udhëzime aty ku është e nevojshme dhe do të trajtojë rastet kur mund të lindin konflikte me një anëtar të Komitetit Rajonal. Komiteti i jep njoftime periodike Komitetit të Auditimit dhe Rrezikut në Titan.
- **Komiteti i Auditimit dhe Rrezikut** i Titan-it ka përgjegjësinë e përgjithshme për monitorimin e efektivitetit të sistemit të raportimit dhe hetimit të sinjalizimit. Komiteti trajton rastet kur mund të lindin konflikte me anëtarët e Komitetit Mbikëqyrës, anëtarët e ExCom ose RRM, dhe i raporton periodikisht Bordit të Drejtorëve për shqetësimet e raportuara për sinjalizim, rezultatet e hetimeve dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Rishikimi i Raporteve

Një raport i pranuar/marrë arkivohet dhe nuk hetohet më tej, nëse ka të bëjë me njërën nga pikat në vijim:

- sjellja e supozuar nuk përbën shqetësim për sinjalizim sipas fushëveprimit të kësaj Politike, përmbajtja e raportit është e pakuptueshme, krejtësisht e pamjaftueshme ose joserioze;
- kur raporti nuk është bërë me mirëbesim ose është keqdashës;
- shqetësimi për sinjalizim i raportuar është i adresuar ose zgjidhur;
- ka kufizime sipas ligjeve kombëtare në fuqi që ndalojnë hetimin e shqetësimit për sinjalizim.

Pyetjet ose shqetësimet e tjera që nuk përbëjnë shqetësime për sinjalizim, do t'u përcillen individëve ose funksioneve përgjegjëse, për t'i adresuar ato dhe për t'u përgjigjur në përputhje me rrethanat. Në këtë kontekst, pyetjet e rregullta komerciale do t'i përcillen departamentit komercial për veprime të mëtejshme.

Raportet për Vendim

Për raportet e mbështetura, pasi të përfundojë hetimi, do të përgatitet një Raport Hetimor, i cili do të përcaktojë të paktën faktet kryesore të raportuara, hetimin e kryer, provat që janë marrë parasysh, konstatimet dhe planin e propozuar të veprimit.

Raporti Hetimor do t'i dorëzohet Komitetit Mbikëqyrës, Drejtorit Rajonal përkatës, Menaxherit të Përgjithshëm të BU-së (nëse është e aplikueshme), dhe anëtarëve të tjerë të menaxhmentit ekzekutiv në përputhje me rrethanat, duke përfshirë Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Departamentin Ligjor të Grupit. Vendimi për planet e duhura të ndërhyrjes dhe veprimet korrigjuese, të cilat mund të përfshijnë masa të brendshme disiplinore dhe/ose ligjore/gjyqësore sipas nevojës, do të merret nga nivelet e duhura të menaxhmentit ekzekutiv, Departamenti Ligjor dhe i Burimeve Njerëzore, në varësi të natyrës dhe peshës së rastit. Organet shqyrtuese, duke përfshirë Departamentin për Auditimin e Brendshëm ose Departamentin e Pajtushmërisë dhe Kundër Mashtrimit, nuk kanë autoritetin për të vendosur ose caktuar ndonjë masë disiplinore.

Objektiviteti dhe Pavarësia

Nëse ndonjë person i përfshirë në procesin e trajtimit dhe hetimit të raportit të brendshëm, siç përshkruhet më lart, përballlet me një konflikt interesi që rrjedh ose lidhet me një shqetësim për sinjalizim që është raportuar, atëherë ai person do të përjashtohet nga procesi i trajtimit dhe hetimit të shqetësimit specifik për sinjalizim.

Në varësi të çdo ligji kombëtar të zbatueshëm, në rast se një anëtar i Komitetit Rajonal është i përfshirë në një shqetësim për sinjalizim që është raportuar, atëherë Komiteti Rajonal do të anashkalohet dhe vetëm Komiteti Mbikëqyrës do të marrë raportin dhe do ta trajtojë atë.

Në varësi të çdo ligji kombëtar të zbatueshëm, në rast se një anëtar i Komitetit Mbikëqyrës, Komitetit Ekzekutiv të Grupit Titan ose RRM përfshihet në një shqetësim për sinjalizim që është raportuar, atëherë Komiteti Rajonal dhe Komiteti Mbikëqyrës do të anashkalohen dhe vetëm Komiteti i Auditimit dhe Rrezikut i Titan-it do të marrë raportin dhe do ta trajtojë atë.

ANONIMITETI

Raportet mund të bëhen nga personat raportues në mënyrë anonime ose duke dhënë emrin e tyre. Anonimiteti sigurohet absolutisht kur një person raportues dorëzon një raport në platformën Ethicspoint, dhe vendos të mbetet anonim. Prandaj, ekzistojnë disa kontrolle teknike efektive. EthicsPoint nuk gjeneron ose mirëmban asnjë regjistër të brendshëm të lidhjeve me IP adresë, kështu që nuk ka asnjë informacion që lidh kompjuterin e personit raportues me EthicsPoint. Në fakt, EthicsPoint është e angazhuar me kontratë të mos ndjekë identitetin e personit raportues.

Megjithatë, Grupi Titan inkurajon sinjalizuesit të japin identitetin e tyre për të lehtësuar hetimin e raporteve të tyre.

Në varësi të ligjeve kombëtare në fuqi, të gjitha raportet, qofshin anonime ose jo, do të vlerësohen duke marrë parasysh faktorët e përshtatshëm, si serioziteti i çështjeve të ngritura, besueshmëria e raportit dhe gjasat për të konfirmuar pretendimin nga burimet në dispozicion. Sinjalizuesve mund t'u kërkohej të japin sqarime gjatë hetimit të raportit.

KONFIDENCIALITETI

Raportet do të trajtohen në mënyrë konfidenciale. Titan zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar që vetëm individët, përfshirja e të cilëve është e nevojshme për trajtimin ose hetimin e një raporti, mund të kenë njohuri për identitetin e sinjalizuesit, ose çdo informacion tjetër nga i cili mund të konkludohet drejtpërdrejt ose tërthorazi identiteti i sinjalizuesit.

Të gjithë personave, përfshirë sinjalizuesin, u kërkohej të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me çdo raport, hetim dhe konstatim.

Identiteti i një sinjalizuesi nuk zbulohet/shpaloset, përveç në rrethana të caktuara të jashtëzakonshme, duke përfshirë kur:

- sinjalizuesi autorizon një zbulim/shpalosje të tillë.
- kjo kërkohej nga çdo procedurë ligjore e mëvonshme sipas ligjit në fuqi, në hetimet që bëhen nga autoritetet kombëtare ose në procedurat gjyqësore, ose në masën e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e personit raportues;
- një sinjalizues vepron me keqbesim dhe me keqdashje bën një deklaratë të rreme.

Në cilindo nga rastet e mësipërme, Grupi Titan do të njoftojë sinjalizuesit përpara se të zbulohet/shpaloset identiteti i tyre, përveç rasteve kur një njoftim i tillë nuk lejohet sipas ligjeve kombëtare në fuqi ose do të rrezikonte hetimet ose procedurat gjyqësore përkatëse.

MBROJTJA KUNDËR HAKMARRJES

Sinjalizuesit që janë staf i Grupit Titan ose kushdo që ka marrë pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi në hetimin e një raporti do të mbrohen, me kusht që raportet të bëhen me mirëbesim dhe me besimin e arsyeshëm se raporti ka pasqyruar një shqetësim për sinjalizim.

Grupi Titan nuk do të tolerojë asnjë lloj hakmarrje ndaj një sinjalizuesi ose kujtdo që ka marrë pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi në hetimin e raportit dhe do të bëjë çmos për të mbrojtur sinjalizuesit nga trajtimi i dëmshëm, si p.sh.

(a) pezullimi, largimi nga puna, shkarkimi ose masat e barasvlershme; (b) ulja në pozitë ose ndalimi i ngritjes në pozitë; (c) transferimi i detyrave, ndryshimi i lokacionit të vendit të punës, zvogëlimi i pagës, ndryshimi i orarit të punës; (d) ndalimi i trajnimit; (e) vlerësimi negativ i performancës ose referencë negative për punësim; (f) shqiptimi ose administrimi i ndonjë mase disiplinore, vërejtje ose dënimi tjetër; (g) diskriminimi, kërcënimi, trajtimi i pafavorshëm ose i padrejtë.

Sinjalizuesit, dëshmitarët ose personat e përfshirë në trajtimin dhe hetimin e një raporti, të cilët besojnë se i janë nënshtruar një trajtimi të dëmshëm, duhet të kontaktojnë menjëherë Departamentin e Grupin ose lokal të Burimeve Njerëzore ose Departamentin e Grupin ose lokal Ligjor, Auditimin e Brendshëm dhe Pajtueshmërinë e Grupit, ose të bëjnë një raport të ri. Sipas Politikës, Grupi Titan rezervon çdo të drejtë për të ndërmarrë veprimet e nevojshme, duke përfshirë veprimet dhe masat ligjore ose gjyqësore ose masat disiplinore ndaj çdo personi që angazhohet në hakmarrje ose kërcënon se do hakmerret ndaj sinjalizuesve.

Ligjet kombëtare gjithashtu mund t'u ofrojnë sinjalizuesve masa mbështetëse (përfshirë mbështetjen financiare dhe psikologjike në procedurat ligjore).

KEQBESIMI DHE AKUZAT E RREME

Grupi Titan e konsideron ngritjen e akuzave keqdashëse si një çështje serioze disiplinore. Grupi Titan nuk do të tolerojë raportimin e shqetësimeve për sinjalizim me keqbesim ose bërjen e akuzave të rreme. Sinjalizuesit që me qëllim të keq kanë bërë pretendime të rreme do t'i nënshtrohen masave disiplinore, duke përfshirë ndërprerjen e punësimit dhe masa të tjera të pafavorshme. Grupi Titan mund të ndërmarrë gjithashtu veprimet e duhura ligjore për të mbrojtur stafin, të drejtat, pasuritë dhe reputacionin e tij kundër kujtqdo që, me keqbesim, ka bërë raportime të rreme ose keqdashëse.

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me çdo raport do t'i nënshtrohet ligjeve në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe politikave të mbrojtjes së të dhënave të secilës kompani të Grupit Titan, duke përfshirë Politikën e Grupit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Njoftimin përkatës të Privatësisë. Të dhënat personale të cilat qartazi nuk janë relevante për trajtimin e një raporti specifik nuk do të grumbullohen ose, nëse grumbullohen aksidentalisht, do të fshihen pa vonesa të panevojshme.

RUAJTJA E RAPORTEVE TË DORËZUARA

Të gjitha raportet e dorëzuara dhe të dhënat përkatëse të hetimeve do të mbahen në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe në një mënyrë që garanton konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast të procedurave ligjore ose të tjera që rrjedhin nga raportet ose në lidhje me raportet, raportet do të mbahen për një periudhë të përshtatshme dhe të nevojshme deri në përfundimin e procedurave ligjore, gjyqësore ose disiplinore, duke përfshirë çdo apelim të mëvonshëm.

TRAJNIMI

Trajnime të rregullta dhe të përshtatshme do t'i ofrohen të gjithë stafit të Grupit Titan, duke përfshirë menaxherët e linjës dhe çdo individ tjetër të përfshirë në hetimin e shqetësimeve për sinjalizim sipas kësaj Politike.

Informacioni dhe udhëzimet për dorëzimin e raporteve do të jenë në dispozicion në Intranet si dhe në faqen e internetit të Grupit Titan ([Materialet Titan](#)).

ADMINISTRIMI I POLITIKËS

Departamenti i Grupit për Pajtueshmërinë dhe Kundër Mashtrimit do të jetë përgjegjës për administrimin e kësaj Politike. Kjo Politikë rishikohet të paktën çdo vit nga Departamenti i Grupit për Pajtueshmërinë dhe Kundër Mashtrimit, së bashku me ekipin ligjor të Grupit, për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore të zbatueshme, duke përfshirë Direktivën e BE-së për Sinjalizimin.

Çdo shqyrtim i kësaj Politike do të miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i Grupit dhe do të rishikohet nga Komiteti i Titan-it për Auditimit dhe Rrezik.